



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 33

Datë: 08. 07. 2020. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Çemalij Kurtiši.

SKQZ: Ylli Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthysese: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
  2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për adresimin e rekondimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit
  3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve të Auditorit të Brendshëm në KQZ
  4. Të ndryshme
-

## **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 33-të të KQZ-së ? A e miratojmë rendin e ditës, nëse nuk ka vërejtje! Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë. Urdhëro Yll...

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për adresimin e rekondimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit**

**Yll Buleshkaj:** Ne, kemi pranuar më 11 të muajit qershor raportin nga Zyra e Auditimit dhe brenda afatit prej 30 ditë, ta dërgojmë një plan te kjo zyre për zbatimin e këtyre rekondimeve. Po shpresoj të keni pasur kohë ta shikoni! I kemi 4 rekondime...

Rekomandojmë që t'i aprovoni, kështu siç i kemi paraqitur!

**Arianit Elshani:** A janë imputet edhe prej auditorit të brendshëm ?

**Alim Rama:** A jemi duke fol për periudhën e njëjtë të auditimit, 2019: s'i te auditori i brendshëm, si te auditori i jashtëm.

**Valdete Daka:** Kjo është me kërkesë tonë...!

**Alim Rama:** Unë kam pyetje: te rekondimet, kryetarja... ( duhet me qenë "kryesuesja"). Unë, nuk po shoh askund në ligj që kryetarja e KQZ ka rol të veçantë në menaxhimin e Financave Publike. Nëse këtë rol e merr kryesuesja, ne s'kemi mundësi me e mbikëqyrë. Unë, propozoj që këtë rol ta ketë Krye shefi, ose Sekretariati...

**Sami Hamiti:** Ligji i Auditimit s'ka të bëj me Ligjin mbi Financat Publike. Këtu, vetëm i drejtohet kreut të institucioneve. Kaq...

**Sylejman Gashi:** Është obligimi sekretariati për me zbatua një plan veprimi mbas 1 muaji. Çështja, e të gjeturave e këtij rapporti, është kurdo që ju merreni vesh. Mendoj, që sot është çështja të diskutohet plani...

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me planin, me diskutimin e këtij plani. E kemi rekondimin e parë: "Paga dhe mëditje", është rekondimi dhe veprimet që i ka përshkruar Sekretariati. A ka dikush...?

**Eshref Vishi:** Ne jemi brenda afatit ligjor kur duhet që Sekretariati ta bëjë planin e veprimit mbi bazën e rekondimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Është në rregull sepse Sekretariati i ka përpunuar të gjitha rekondimet, gjetjet e rapportit, dhe është dekluaruar për afatshmërinë e zbatimit të këtyre rekondimeve. Ajo që ne na intereson si KQZ, është që Sekretariati të veproj brenda afatit – brenda afatit që i ka paraparë për t'i ndërmarrë për zbatimin e secilit rekondim. Ne, jemi pro këtyre afateve,

dhe ne duhet ta përcjelim punën e Sekretariatit. Nganjëherë, në të kaluarën ato nuk janë përmbushur, sidomos ato rrëth punësimeve...!

Almi Rama: Gjetja është e qartë: nuk janë zbatue procedurat e rekrutimit të stafit të përkohshëm! Pra, afati duket të jetë më 31 tetor, pse Serketariati e kufizion vetën. Duhet të ndërrohet praktika për këtë proces, dhe për proceset e ardhshme...

Ylli Buleshkaj: Edhe me ligj jemi të lejuar me procedura të shkurtuara, por ne duhet të kemi një procedurë të rregullt se s'i duhet të zgjidhet stafi jo i rregullt. Pra, ne kemi afat që deri më 31 tetor, t'i kryejmë procedurat për rekrutim... Ne, këtë duhet ta kryejmë: patëm apo nuk patëm zgjedhje...

**Arianit Elshani:** E kam lexuar këtë pikë me vëmendje, mirëpo kam vërejte se në këtë pikë mungon roli i Këshillit të Personelit. Këtu, edhe me rregullore është që komisioni duhet të përfshihet sepse, është edhe në kompetencën e tij... Sidomos, për stafin jo permanent...

**Sulejman Gashi:** Po, nga i pari duhet të jetë Komisioni për Personel...

Në shqyrtim të kësaj pike, diskutuan: Valdete Daka dhe Eshref Vishi.

Valdete Daka: Nëse nuk kemi tjetër të diskutojmë, atëherë e hedh në votim. Kush është për aprovimin e këtij plani të veprimit...?

Me 2 vota abstenim, anëtarët e KQZ-së prezent aprovuan Planin e Veprimit për Adresimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve të Auditorit të Brendshëm në KQZ**

*P.s. Kjo pikë e rendit të ditës, është shqyrtuar me dyer të mbyllura për shkak se e gjitha, ka të bëj me Sekretariatin.*

### **4. Të ndryshme!**